



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

VENDIM

Nr. 5, datë 25 01.2021

PËR VLERËSIMIN DHE PIKËZIMIN E KANDIDATURËS SË Z. BESNIK MAHO NË VENDIN VAKANT PËR INSPEKTOR JO MAGJISTRAT, SHPALLUR NGA INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË NË DATËN 07.02.2020.

KOMITETI I EMËRIMIT EDHE VLERËSIMIT TË INSPEKTORËVE i përbërë nga :

Artur Metani - Kryetar

Mirela Kapo - Anëtare

Marsela Pepi- Anëtare

Asistuar nga sekretare Adela Skora,

në mbledhjen e datës 13. 01.2021, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

INSPEKTOR JO MAGJISTRAT

Z. BESNIK MAHO

OBJEKTI:

Vlerësimi dhe pikëzimi i kandidaturës së z. BESNIK MAHO, në vendin vakant për Inspektor jo magjistrat, të shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 07.02.2020.

KOMITETI PASI :

U njoh me aktet si edhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, pikës 3 dhe 77, të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisë të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, në datë 07.02.2020, ka vendosur fillimin e procedurës përzgjedhëse të kandidatëve jomagjistratë që kanë shprehur interes për pozicionin e inspektorit, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

2. Në përfundim të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka filluar shqyrtimin e aplikimeve të kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 209 dhe 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

3. Ndërmjet kandidatëve që kanë shprehur interesin për plotësimin e këtij vendi vakant për Inspektor jo magjistratë në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është edhe zoti BESNIK MAHO.

4. Në zbatim të nenit 147/d të Kushtetutës dhe të nenit 209 e vijues të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të gërmës A, pikës 3 dhe 77, të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisë të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën

dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në mbledhjen e zhvilluar në datën 07.02.2020, vendosi fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve që kanë shprehur interesin për vendin vakant për Inspektor jo magjistratë pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

5. Në zbatim të nenit 147/d të Kushtetutës dhe të nenit 209 e vijues të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të pikës 27, të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisë të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, pas administrimit të të gjithë dokumentacioni, në mbledhjen e zhvilluar në datën 26.10.2020, është realizuar dhe rrada e shqyrtimit të dosjes që i përket cdo kandidati.

6. Zoti BESNIK MAHO, si njëri ndër kandidatët që ka shprehur interesin për vendin vakant të sipërcituar për Inspektor jo magjistratë pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, pikës 3 dhe 77, të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisë të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, me kërkesën me nr.prot 106, në datën 14.02.2020 ka shprehur interes për pozicionin e inspektorit, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Rrjedhimisht, nisur dhe nga detyrimet ligjore, kandidati, është njoftuar me shkrim për tu paraqitur pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për të vijuar me përmbushjen e procedurave të

verifikimit të kandidaturës. Njoftimi me shkrim, i kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidati, gjendet e administruar në dosjen e kandidimit.

7. Në datën 28.04.2020, kandidati BESNIK MAHO, është paraqitur pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidatit të Deklaratës përkatëse, e cila gjendet e administruar në dosjen e kandidimit.

8. Në datën 04.05.2020, kandidati BESNIK MAHO, ka depozituar në sekretarinë e zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, formularë të deklarimit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidimit.

Meritat profesionale – Historiku Arsimor dhe Profesional

9. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidati BESNIK MAHO, ka ushtruar veprimtaritë profesionale si më poshtë:

Lloji i detyrës/funksionit/veprimtarisë : Trajner/ekspert i jashtëm në Shkollën e Magjistraturës.

Përmbledhje e përgjegjësiave të ushtruara : Zhvillimin e leksioneve me studentët e Shkollës të Magjistraturës, si dhe seminare me gjyqtarë të gjykatave të ndryshme të vendit, konkretisht:

- Janar 2008, leksione në lidhje me procesin e njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronave, me studentët e vitit të dytë të Shkollës të Magjistraturës;
- Janar-Shkurt 2014, leksione në lidhje me procesin e njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronave, problematikat gjyqësore, si dhe mënyra të tjera të fitimit të pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme me studentët e vitit të dytë të Shkollës të Magjistraturës;
- Janar-Shkurt, 2015 leksione në lidhje me procesin e njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronave, problematikat gjyqësore, si dhe mënyra të tjera të fitimit të pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme me studentët e vitit të dytë të Shkollës të Magjistraturës;

- Shkurt 2019, në rolin e ekspertit ka zhvilluar katër ditë seminare në kuadrin e trajnimeve vazhduese në tema të karakterit procedural dhe material që kanë të bëjnë me aktet procedurale dhe provat në procesin gjyqësor civil, kur janë të pavlefshme apo nuk mund të përdoren, veprimet juridike civile me kusht dhe aspekte të pronësisë intelektuale në Republikën e Shqipërisë;
- Maj-Qershor, 2020, në rolin e ekspertit ka zhvilluar katër ditë seminare në kuadrin e trajnimeve vazhduese në tema të karakterit të ligjit procedural dhe material, që kanë të bëjnë me ligjin nr.111/2018 “Për kadastrën”, ligjin nr.20/2020 ‘Për mbylljen e proceseve kalimtare”, veprimet juridike dhe administrative me kusht në fushën e fitimit të pronësisë mbi pasuritë e paluajtëshme, mënyra e marrjes së dëmshpërblimit për ndërtimet pa leje, instituti i shpronësimit dhe ai i shkakimit të dëmit, parë të gjitha këto marrëdhënie juridike në kuadrin e problematikave administrative dhe gjyqësore që ekzistojnë sot në Republikën e Shqipërisë;

Lloji/emërtesa e Institucionit/subjektit ku është ushtruar veprimtaria: Shkolla e Magjistraturës

Periudha :Tetor 2019 dhe aktualisht

Lloji i detyrës/funksionit/veprimtarisë : Pedagog i jashtëm/brendshëm pranë Departamentit të së Drejtës Private në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit European te Tiranës, në lëndën: “Fitimi i pronësisë mbi pasuritë e paluajtëshme”, leksione dhe seminare në Programin Master Shkencor. “E drejta Civile I”, leksione dhe seminare në Programin Bachelor

Përmbledhje e përgjegjësisë të ushtruara : Zhvillimin e leksioneve dhe siminareve.

Lloji/emërtesa e Institucionit/subjektit ku është ushtruar veprimtaria : Fakulteti i Drejtësisë të Universitetit European te Tiranës.

Periudha :Shkurt 2018 dhe aktualisht

Lloji i detyrës/funksionit/veprimtarisë : Pedagog i brendshëm/jashtëm pranë Departamentit të së Drejtës Private në Fakultetin e Drejtësisë të Kolegjit Universitar “Luarasi”, në lëndët: “Teknikë legjislative” dhe “Pronësi Intelektuale” në Bachelor dhe “E drejta Europiane Private”, leksione dhe seminare dhe “Twa drejtat e njeriut dhe jurisprudenca e GJEDNJ” në Programin Master Shkencor.

Përmbledhje e përgjegjësive të ushtruara : Zhvillimin e leksioneve dhe seminareve.

Lloji/emërtesa e Institucionit/subjektit ku është ushtruar veprimtaria : Fakultetin e Drejtësisë të Kolegjit Universitar “Luarasi”.

Periudha :Nëntor 2018- Tetor 2019

Lloji i detyrës/funksionit/veprimtarisë : Këshilltar pranë Ministrisë të Drejtësisë në kuadrin e programit Leadership Albania 2018-2019 në kuadrin e marrëveshjes të bashkëpunimit të AADF me Qeverinë Shqiptare.

Përmbledhje e përgjegjësive të ushtruara : Në varësi të detyrave dhe përgjegjësive të ngarkuara nga Ministri i Drejtësisë ka përgatitur raporte/memo, duke sugjeruar dhënien e opinioneve ligjore dhe cdo informacion tjetër të dobishëm që i shërben përmbushjes së rregullt të detyrës dhe qëllimeve të ligjshme që duhet të ndjekë ky funksionar publik.

Lloji/emërtesa e Institucionit/subjektit ku është ushtruar veprimtaria : Ministria e Drejtësisë .

Periudha : Mars 2015- dhjetor 2017

Lloji i detyrës/funksionit/veprimtarisë : Marrjen e masave për zhvillimin e konferencave, seminareve dhe mirëmbajtjes ne Sofitel, pjese e La Touraine LLC, Chicago Il dhe Catholic Community of St.Pius X.

Përmbledhje e përgjegjësive të ushtruara : Sigurimi i shërbimeve per mirembajtjen e institucionit privat ne kuadrin e orrganizimit të seminareve dhe konferencave. Sigurimi i shërbimeve per mirembajtjen e institucionit shkollor.

Lloji/emërtesa e Institucionit/subjektit ku është ushtruar veprimtaria : La Touraine LLC, Chicago Il dhe Catholic Community of St.Pius X.

Periudha :Tetor 2008-Shkurt 2015

Lloji i detyrës/funksionit/veprimtarisë : Pedagog/Përgjegjës Departamenti i së Drejtës Private në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit European te Tiranës, në lëndët:

“E drejta e procedurës civile”, leksione dhe seminare:

“E drejta e profesioneve të lira”, leksione dhe seminare në Bachelor;

“E drejta e konkurences dhe konsumatorit”, seminare dhe leksione në Bachelor;

“E drejtat e mjedisit dhe pasurive te paluajtshme”, seminare dhe leksione në Bachelor;

“E drejte e biznesit” ne nivelin DND ;

“Pronesi Intelektuale” ne Bachelor si dhe “Pronesi Intelektuale ne BE” ne nivelin DND ;

“E drejta e detyrimeve” në Bachelor;

“Pasuritë e paluajtshme” në Master Shkencor;

“Procedura Civile e Krahasuar” në Master Shkencor;

“Studime të Avancuara në të Drejtën e Detyrimeve” në Doktoraturë;

Përmbledhje e përgjegjësive të ushtruara : Zhvillimin e leksioneve dhe seminareve. Organizimin, drejtimin duke menaxhuar të gjithë punën e pedagogëve të Departamentit të së Drejtës Private në UET (periudha Tetor 2009-Shtator 2010, si dhe gjatë vitit akademik Tetor 2013-Shtator 2014).

Lloji/emërtesa e Institucionit/subjektit ku është ushtruar veprimtaria : Fakulteti i Drejtësisë të Universitetit European te Tiranës .

Adresa dhe kontaktet e Institucionit/subjektit : Bulevardi Gjergj Fishta Nd. 70 H.1, Njësia Bashkiake Nr.7 Tirana AL, 1023

Periudha : Mars 2012- Janar 2015

Lloji i detyrës/funksionit/veprimtarisë : Profesion i lirë/Avokat

Përmbledhje e përgjegjësive të ushtruara : Ka përfaqësuar dhe mbrojtur ceshtje gjyqësore të shumta të llojeve te ndryshme, në fushën e së drejtës civile, penale dhe administrative, të cilat më kanë krijuar mundësinë të marr pjesë ne procese gjyqësore në favor të subjekteve që ka përfaqësuar, në formën e konsulencave, pergatitjes të akteve proceduriale, si dhe përfaqësimit të subjekteve private në organet administrative dhe ato të drejtësisë.

Lloji/emërtesa e Institucionit/subjektit ku është ushtruar veprimtaria : Profesion i lirë (avokat) me Nr.1447 Lic dhe Nr.L24304006 G Nipti .

Periudha : Qershor 2007- Maj 2008

Lloji i detyrës/funksionit/veprimtarisë : Drejtor i Përgjithshëm i AKKP-së

Përmbledhje e përgjegjësive të ushtruara : Ka drejtuar dhe organizuar veprimtarinë e Agjensisë të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm, institucion i përbërë prej 150 punonjesh gjithsej, nga të cilët 100 punonjesh përbushin detyrimet ligjore në 12 qarqe të vendit në nivel lokal, ndërsa 50 punonjesh të tjerë përbushnin detyrimet ligjore në kryeqytet në nivel qendror.

Lloji/emërtesa e Institucionit/subjektit ku është ushtruar veprimtaria : Funkionar i lartë në Administratën Shtetërore.

Adresa dhe kontaktet e Institucionit/subjektit : Rr. Muhamet Gjollësja, Nr. 54, Tiranë, Shqipëri.

Periudha : Tetor 2004- Qershor 2007

Lloji i detyrës/funksionit/veprimtarisë : Gjyqtar pranë Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe Pogradec.

Përmbledhje e përgjegjësive të ushtruara : Ka gjykuar çështje të natyrës civile, penale dhe administrative. Në zgjidhjen e shumë konflikteve gjyqësore me karakter civil dhe penal, është përpjekur të zgjidh konfliktet e paraqitura në varësi të shkaqeve dhe të hapësirës për të pajtuar palët ndërgjyqëse. Në këtë mënyrë konflikte të natyrës familjare, konflikte civile të natyrave nga me të ndryshmet, si dhe akuza penale të karakterit privat, të sjella në gjykim nga ana e të dëmtuarit akuzues është përpjekur t'i zgjidh me pajtim, në të mirë të interesave të dyja palëve ndërgjyqëse. Në të kundërt kur cdo hapësirë për të zgjidhur me pajtim konfliktet e paraqitura me siper ka deshtuar, ka zbatuar ligjin material dhe atë procedural.

Lloji/emërtesa e Institucionit/subjektit ku është ushtruar veprimtaria : Funkionar i pushtetit gjyqësor.

Periudha : Korrik 2001- Korrik 2002

Lloji i detyrës/funksionit/veprimtarisë : Profesion i lirë/As.Avokat dhe Avokat

Përmbledhje e përgjegjësiave të ushtruara : Në varësi të detyrave dhe të porosive të ngarkuara nga drejtuesi i zyrës të avokatisë ku ka kryer stazhin një vjeçar, ka ndjekur, shoqëruar dhe asistuar atë në përgatitjen e projekt-akteve të ndryshme proceduriale kryesisht të natyrës penale, civile dhe familjare.

Lloji/emërtesa e Institucionit/subjektit ku është ushtruar veprimtaria : Profesion i lirë. As.avokat fillimisht dhe më pas Avokat me Nr.1447 Lic .

Adresa dhe kontaktet e Institucionit/subjektit : Pranë studios ligjore të Av.Sajmir Vishaj, avokat i Dhomës të Avokatisë Tiranë me adresë përballë me Prokurorinë pranë Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Historiku Arsimor

11. Në shkronjën “a” të pikës 6 të nenit 209 të ligjit nr.115/2016 përcaktohet si kriter vlerësimi rezultatet e arritura nga kandidati gjatë studimeve në studimet universitare. Në zbatim të këtij kriteri vlerësues dhe të Urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Komiteti ka çmuar që të vlerësohen me 1 pikë kandidatët që kanë pasur notë mesatare dhe me 2 pikë për notën mesatare mbi 9.

12. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidati BESNIK MAHO ka përfunduar studimet per:

Në bazë të certifikatës së notave të lëshuar vitin 2001¹ rezulton se zonja BESNIK MAHO është diplomuar si Jurist, në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit Tiranw , me notë mesatare 9.6;

Titujt akademikë dhe gradat shkencore

¹ Të dhëna të mara nga Cv e kandidatit.

13. Nga aktet që ndodhen në dosjen e kandidimit rezulton se kandidati Besnik MAHO, ka këto tituj:

ARSIMIMI

(Renditen të gjitha, në zbritje kohore, duke filluar nga lloji më i fundit i arsimimit)

Periudha : Tetor 1997-Korrik 2001

Diploma/Titulli i fituar : “Jurist”

Rezultati/Nota Mesatare : 9.6

Emri dhe lloji i institucionit arsimor : Fakulteti i Drejtësisë të Universitetit të Tiranës

Adresa dhe kontaktet e institucionit arsimor : Rruga Milto Tutulani, Tiranë.

KUALIFIKIMET PASUNIVERSITARE

14. *(Renditen të gjitha, në zbritje kohore, duke filluar nga lloji më i fundit i arsimimit)*

Periudha : Nentor 2010-Nentor 2016

Diploma/Titulli i fituar : Dr/Doktor në shkencat historike për temën “Ceshtje të pronësive mbi sende të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë. Vështrim historik.”

Rezultati/Nota Mesatare :

Emri dhe lloji i institucionit arsimor : Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë i Universitetit të Tiranës.

Adresa dhe kontaktet e institucionit arsimor : Rr. e Elbasanit, Tiranë * Tel: (+355 4) 22369987 *

E-mail: fhf@fhf.edu.al .

Periudha : Shkurt 2006- Mars 2008

Diploma/Titulli i fituar : Ka përfunduar studimet pasuniversitare në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës SH.P.U dhe ka marrë titullin MA.

Rezultati/Nota Mesatare : 9.7

Emri dhe lloji i institucionit arsimor : Fakulteti i Drejtësisë i Universitetit të Tiranës.

Adresa dhe kontaktet e institucionit arsimor : Rruga Milto Tutulani, Tirana

15. Periudha : Tetor 2002- Korrik 2005

Diploma/Titulli i fituar : Perfunduar shkollën e Magjistraturës, ku ka marë titullin “Magjistrat për gjyqtar”.

Rezultati/Nota Mesatare : Shumica e lëndëve ‘shumë mirë’

Emri dhe lloji i institucionit arsimor : Shkolla e Magjistraturës

16. Prandaj, në zbatim të ligjit, Komiteti vlerëson me pikë llojin e titujve akademikë dhe gradave shkencore, llojin, kohëzëjatjen, fushën dhe vendin e kryerjes së kualifikimeve pasuniversitare, studimeve, specializimeve dhe trainimeve të kandidatëve, duke pasur parasysh shpërndarjen e pikëve, si edhe orientimet që përmbahen në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për Inspektor Jomagjistrat.

17. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidati BESNIK MAHO ka ndjekur studimet pasuniversitare të Masterit, studimet pasuniversitare të llojit “doktoraturw” si dhe ka mbaruar shkollwn e Magjistraturws, “profili gjyqtar”.

18. Gjithashtu, rezulton që kandidati BESNIK MAHO ka ndjekur studimet pasuniversitare në Universitetin e Tiranës, grada shkencore “Doktor” në fakultetin e Drejtësisë.

19. Për këto arsye, për kriterin e vlerësimit “tituj, grada shkencore” nisur nga marrja e gradës shkencore “doktor i shkencave” “magjistrat” dhe “Master”, Komiteti çmoi ta vlerësojë kandidatin BESNIK MAHO me 5 (pesw) Pikë.

20. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidati BESNIK MAHO ka kryer trajnime:

- **Periudha : Prill 2019-Maj 2019**

- Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar : Ndjekur dy kurse të rëndësishme në Harvard, Ekspert in Master Negotiations dhe në Bruksel Certificate in Leadership Program
Emri dhe lloji i institucionit arsimor : Harvard, Massachusetts, USA dhe Brussels, Belgium

Adresa dhe kontaktet e institucionit arsimor : Massachusetts Hall Cambridge, MA 02138.
Tel: (617) 495-1000 dhe Rue Neerveld 101/103, 1200 Èoluëe-Saint-Lambert, Belgium.

- **Periudha :Nëntor 2018-Tetor 2019**

- Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: Seminare të ndryshme të organizuara në ambjentet e AADF-së dhe jo vetëm, me tematika të ndryshme të karakterit politik, social dhe ekonomik me ekspertë të njohur vendas dhe të huaj.

Emri dhe lloji i institucionit arsimor : Albanian American Development Foundation (AADF)

Adresa dhe kontaktet e institucionit arsimor : Str. Ibrahim Rugova, Green Park Complex, Toëer 2, 12th Floor, Postal Code 1019, Tiranë.

- **Periudha : Korrik 2015-Nëntor 2017**

- Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar : Kam ndjekur nje sërë kursesh për ESL, Academic English, Real-Estate dhe Legal Research ne kuader te sistemit amerikan Èestlaë Next.

Emri dhe lloji i institucionit arsimor : College of DuPage ne Glen Ellyn, Illinois, USA.

Adresa dhe kontaktet e institucionit arsimor : College of DuPage. 425 Faëell Blvd., Glen Ellyn, IL 60137.

- **Periudha : Tetor 2009-Dhjetor 2014**

- Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar : Kam ndjekur nje sere seminaresh për rritjen e nivelit pedagogjik të organizuara nga drejtuesit e UET në ambjentet e Universitetit dhe në qytete të ndryshme të vendit, për shkak të detyrës si pedagog i brendshëm, si dhe Përgjegjës Departamenti i së Dejtës Private.

Emri dhe lloji i institucionit arsimor : Universiteti European i Tiranës.

Adresa dhe kontaktet e institucionit arsimor : Bulevardi Gjergj Fishta Nd. 70 H.1, Njësia Bashkiake Nr.7 Tirana AL, 1023

- **Periudha : Mars 2006**

- Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar : Ne muajin mars te vitit 2006 kam qene i ftuar ne nje konference 3 (tre) ditore te zhvilluar ne Mal te Zi me teme “Mbrojtja dhe institucionalizimi i familjes” ku kam mare edhe titullin “Ambasador i paqes”.

Emri dhe lloji i institucionit arsimor : Universal Peace Federation dhe Interreligious and International Federation for World Peace

Adresa dhe kontaktet e institucionit arsimor : Adresa dhe kontaktet e institucionit: 866 United Nations Plaza, Suite 529 Neë York, NY 10017, USA

- **Periudha : Tetor 2002-Maj 2007**

- Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar : Kam ndjekur nje sere seminaresh të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës me ekspertë vëndas dhe të huaj, me tematikë të ndryshme që kishin të bënin me diskutimin dhe unifikimin e praktikës gjyqësore në fushën e së drejtës civile, penale dhe administrative, sikurse kane qene:

- Pjesëtimi gjyqësor dhe problemet që kanë lindur në praktikën gjyqësore shqiptare”
- Pronësia intelektuale, raste praktike”
- Ligji “Per kthimin dhe kompesimin e pronave në Shqipëri”
- Ngritja e akuzave te reja në procesin penal”
- Etika Gjyqesore”, etj.
- Emri dhe lloji i institucionit arsimor : Shkolla e Magjistraturës.
- Adresa dhe kontaktet e institucionit arsimor : Rr.”Elbasanit, (Pranë) Fakultetit Gjeologji Minierave Tirana, Albania.

21. Duke pasur parasysh numrin, llojin, kohëzgjatjen dhe tematikat e veprimtarive trainuese të ndjekura nga kandidati BESNIK MAHO, për këtë kriter ligjor vlerësimi Komiteti çmoi ta vlerësojë me **1 (një) Pikë**.

Njohja e gjuhëve të huaja

22. Në Urdhrin Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, përcaktohet si kriter vlerësimi niveli i zotërimit të gjuhëve të huaja.

23. Prandaj në zbatim të ligjit Komiteti vlerëson me pikë llojin dhe numrin e gjuhëve të huaja si edhe nivelin e zotërimit të tyre nga ana e kandidatëve duke pasur parasysh sasinë e pikëve maksimale përkatëse sipas Urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020.

24. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidati BESNIK MAHO zotëron shumë mirë gjuhën angleze dhe gjuhën italiane . Sipas deklaratimit të kandidatit niveli i zotërimit të gjuhës angleze dhe italiane është “shume mire”, në të tre komponentët: të kuptuarit, të folurit dhe me shkrim.

25. Dokumenti i zotërimit të gjuhës së huaj : English as a second language advanced ESL

Emri dhe lloji i institucionit që e ka lëshuar : College of DuPage

Adresa dhe kontaktet e institucionit : College of DuPage. 425 Faëell Blvd, Glen Ellyn, IL 60137.

Periudha : Tetor 2009- Korrik 2010

Dokumenti i zotërimit të gjuhës së huaj angleze: Certificate e përfundimit të niveleve 2, 3 dhe 4 të gjuhës angleze

Emri dhe lloji i institucionit që e ka lëshuar : Meridian Language Center.

Adresa dhe kontaktet e institucionit : Rruga Frederik Shiroka, Tirana.

Periudha : Korrik 2008- Shtator 2008

Dokumenti i zotërimit të gjuhës së huaj : ESL Certificate

Emri dhe lloji i institucionit që e ka lëshuar : City of Waterbury, Connecticut, USA.

Adresa dhe kontaktet e institucionit: Ęaterbury Public Schools 236 Grand Street Ęaterbury, CT 06702.

Periudha :Nentor 2007.

Dokumenti i zotërimit të gjuhës së huaj : Dëshmi e gjuhës të huaj

Emri dhe lloji i institucionit që e ka lëshuar : Fakulteti i Gjuhëve të Huaja pranë Universitetit të Tiranës.

Adresa dhe kontaktet e institucionit : Rr. Elbasanit Tirana Albania AL, 1001.

Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidati BESNIK MAHO zotëron shumë mirë gjuhën angleze.

Kandidati ka përfunduar studimet e plota universitare në **gjuhën Italiane** si dhe disponon dokument të lëshuar nga University of Michigan për certifikimin e njohurive në gjuhën angleze sipas Met Michigan English Test.

26. Për këto arsye, duke pasur parasysh dokumentacionin e administruar, Komiteti çmoi ta vlerësojë kandidatin BESNIK MAHO për këtë kriter ligjor vlerësimi, në total me **(3) Pikë.**

Meritat profesionale – Kualifikimi i Përgjithshëm Profesional

27. Në Urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, konkretisht në shtojcën nr.2, në lidhje me kualifikimin e përgjithshëm profesional, përcaktohen si kriteret vlerësimi, në bazë të treguesve shkencorë, performanca e dalluar dhe rezultatet e larta në ushtrimin e profesionit, që mbështetet ndërmjet të tjerave në botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike, në produktet profesionale sipas profileve të ushtrimit të profesionit, rezultatet e vlerësimit profesional dhe të etikës të kandidatëve në punët që kanë bërë në të shkuarën, nëse ka, ose rezultatet e dallueshme të arritura gjatë përvojave të tyre të punës e që lidhen me ushtrimin e

funksioneve në fushën përkatëse.

28. Prandaj, Komiteti i emërimit dhe vlerësimit të Inspektorëve vlerëson me pikë si sasinë ashtu edhe cilësinë e rezultateve profesionale, me një fokus të veçantë tek cilësia. Në këtë mënyrë, bazuar në të dhënat e mundshme të disponueshme për vlerësim, mbahen parasysh sasia e pikëve maksimale prej 30 pikësh sipas urdhërit nr. 7 referuar si më sipër, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si edhe orientimet për caktimin e mundshëm të një maksimumi prej 25 pikësh për sa i përket vlerësimit cilësor dhe të një maksimum prej 5 pikësh për vlerësimin e sasisë së rezultateve profesionale sipas Metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për Inspektor Jomagjistrat.

29. Në rastin e kandidatit BESNIK MAHO, Komiteti shqyrtoi dokumente profesionale dhe të dhënat që mund të disponoheshin nga veprimtaria e saj profesionale si asistent pedagoge dhe pedagoge, specialiste për marrëdhëniet me gjyqësorin pranë Presidentit të Republikës, juriste pranë Bashkisë Tiranë dhe Këshilltare ligjore pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, etj si edhe nga kontributet e tjera profesionale të këtij kandidati në veprimtari të ndryshme, përfshirë publikime apo punime e artikuj shkencorë.

30. Për sa i përket vlerësimit sasior, Komiteti mbështetet në të dhëna që rezultojnë nga jetëshkrimi dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidati, ku evidentohet angazhimi i saj me kohë të plotë në funksione publike të rëndësishme siç është detyra e pedagoges së jashtme dhe detyra e këshilltares ligjore pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me përgjegjësi, kompetenca dhe ngarkesë pune të dallueshme e të posaçme krahas veprimtarive e detyrave të tjera që rezultojnë nga jetëshkrimi dhe dokumente të tjera provuese të administruara në dokumentacionin e kandidimit.

31. Gjithashtu, nga dokumentacioni i administruar dhe duke pasur parasysh profilet e veprimtarive profesionale, rezulton se kandidati BESNIK MAHO në cilësinë e autores ka përgatitur artikujt shkencorë, publikime profesionale dhe dokumente të tjera profesionale si brenda ashtu edhe jashtë vendit, të cilat janë të fokusuara kryesisht në fushën e të drejtës kushtetuese, fusha të ndryshme të së drejtës publike, të së drejtës penale ndërmjet të cilave

kandidati ka zgjedhur të paraqesë pranë Komitetit dokumentet që tregohen më poshtë:

- Justice Reform in Albania, publishing in Ninth International Conference on: “Social and Natural Sciences – Global Challenge 2020”. Organized by International Institute for Private, Commercial and Competition Law, Stockholm, Suede, November 2020 with co-authors Aferdita Maho& Besnik Maho
- Real estate reform during the years 2015-2020 in Albania regarding AMTP registration and legalization of ownership, publishing in Tenth International Conference on: “Social and Natural Sciences – Global Challenge 2020”. Organized by International Institute for Private, Commercial and Competition Law, in Lisbon, Portugal, November, 2020 with co-authors Aferdita Maho & Besnik Maho
- Achievements and challenges about re-evaluation process of judges and prosecutors in the republic of Albania. Botuar Ne revisten shkencore austriake me faktor impakti (Academic Journal of Business, Administration, Law and Social Sciences) (AJBALS), Vienne, Austria, November 2020 with co-authors Aferdita Maho& Besnik Maho

Titulli i publikimit/ Kërkimit shkencor : “Padia për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv. Kushtet që duhet të plotesohen për ngritjen dhe shqyrtimin e kësaj padie nga gjykata”.

Autor/Bashkëautor/Kontribues : Besnik Maho

Subjekti/Institucioni botues/publikues : Shkolla e Magjistratures”, Revista “Jeta Juridike”

Koha e botimit : Mars, 2020.

Titulli i publikimit/ Kërkimit shkencor : Ne Konferencen Shkencore Ndërkombëtare “Dinamizmi i reformave dhe ndikimi i tyre në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, politik dhe social”, kam prezantuar punimin “Reformimi i sistemit te drejtesise ne Shqiperi. Sfidat qe ai mbart”.

Autor/Bashkëautor/Kontribues : Besnik Maho dhe Donald Zeqo.

Subjekti/Institucioni botues/publikues : Kolegji Universitar “Luarasi”, Universiteti i Tiranës, Universiteti i Durrësit, etj.

Koha e prezantimit: 25 Maj, 2018.

Titulli i publikimit/ Kërkimit shkencor : “Procesi i njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronave përgjatë njëzet viteve demokraci”.

Autor/Bashkëautor/Kontribues : Afërdita Maho dhe Besnik Maho,

Subjekti/Institucioni botues/publikues : “Albania Socio Economic Review”

Koha e botimit : Dhjetor, 2014.

Titulli i publikimit/ Kërkimit shkencor : “The notion of the judged subject in the context of judicial verdict of the final layout. The existing judicial problematic in this direction”.

Autor/Bashkëautor/Kontribues : Besnik Maho

Subjekti/Institucioni botues/publikues : Shkolla e Magjistratës”, Revista “Jeta Juridike”.

Koha e botimit : Shtator, 2014.

Titulli i publikimit/ Kërkimit shkencor : Ne Konferencën Shkencore Ndërkombëtare “Të rimendojmë zhvillimin dhe integrimin”, kam prezantuar punimin me titull “Risite që solli ligji nr. 9901, dt14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

Autor/Bashkëautor/Kontribues : Besnik Maho dhe Afërdita Maho.

Subjekti/Institucioni botues/publikues : Universiteti Europian i Tiranës.

Koha e prezantimit: 4 Maj, 2014.

Titulli i publikimit/ Kërkimit shkencor : “Kam botuar katër cikle leksionesh për lëndet “Pronesi Intelektuale, “E drejte e mjedisit”, “Profesionet e Lira” dhe “Procedura civile e krahasuar” përgjate viteve 2009-2015.

Autor/Bashkëautor/Kontribues : Besnik Maho

Subjekti/Institucioni botues/publikues : Universiteti European i Tiranës.

Koha e publikimit: Pergjate viteve akademike 2009-2014.

Titulli i publikimit/ Kërkimit shkencor : “Gjykata e Lartë dhe roli që ajo luan në përmirësimin e jurisprudencës gjyqësore”.

Autor/Bashkëautor/Kontribues : Besnik Maho dhe Admir Belishta.

Subjekti/Institucioni botues/publikues : Universiteti European i Tiranës, Revista shkencore “Jus& Justicia”.

Koha e prezantimit: Maj, 2013.

Titulli i publikimit/ Kërkimit shkencor : Konferenca Shkencore Ndërkombëtare “The State, Society and Laë: Human Right`s Challenges in Albania”, kam prezantuar punimin me titull “Risitë, arritjet e procesit të njohjes dhe kompensimit të pronave subjekteve të shpronësuar, si dhe problematika që ai mbart”.

Autor/Bashkëautor/Kontribues : Besnik Maho dhe Ina Xhepa.

Subjekti/Institucioni botues/publikues : Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës & Kolegji Universitar “Luarasi” .

Koha e prezantimit: 15-16 Mars, 2013.

Titulli i publikimit/ Kërkimit shkencor : Konferenca Shkencore Ndërkombëtare “The State, Society and Laë: Human Right`s Challenges in Albania”, kam prezantuar punimin me titull “Regjimi juridik i tokës bujqësore në Republikën e Shqipërisë në rrafshin krahasues. Problemet që ai mbart”.

Autor/Bashkëautor/Kontribues : Besnik Maho dhe Lirika Kutrolli.

Subjekti/Institucioni botues/publikues : Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës & Kolegji Universitar “Luarasi” .

Koha e prezantimit: 15-16 Mars, 2013.

Titulli i publikimit/ Kërkimit shkencor : Konferenca Shkencore “100 vjet pavaresi në fushën e drejtësisë”, organizuar nga UET, ku mbajta referatin me temë “Sistemi i drejtësisë në Republikën e Shqipërisë dhe problematika që e shoqëron sot atë”.

Autor/Bashkëautor/Kontribues : Besnik Maho.

Subjekti/Institucioni botues/publikues : Universiteti Europian i Tiranës.

Koha e prezantimit: Maj, 2012.

Titulli i publikimit/ Kërkimit shkencor : “Bashkëpronësia mes bashkëshortëve në rend evolutiv në Republikën e Shqipërisë”.

Autor/Bashkëautor/Kontribues : Besnik Maho dhe Afërdita Maho.

Subjekti/Institucioni botues/publikues : Revista shkencore “Avokatia”, botim i Dhomes Kombëtare të Avokatisë Tiranë”.

Koha e botimit : Nentor, 2011.

Titulli i publikimit/ Kërkimit shkencor : “The notion of a Global Administrative Order ”.

Autor/Bashkëautor/Kontribues : Migena Leskoviku dhe Besnik Maho.

Subjekti/Institucioni botues/publikues : Revista shkencore nderkombetare me karakter impakti “European Review of Public Law”, botim i EPLO(European Public Law Organization) .

Koha e publikimit: Vol. 23, No. 1, (79), 2011.

Titulli i publikimit/ Kërkimit shkencor : Konferenca Shkencore Ndërkombëtare “National and European Values of Public Administration in the Balkans” e organizuar nga EPLO(European Public Law Organization) ne Specias te Greqise, ku ne bashkautorësi paraqita referatin me titull “The notion of a Global Administrative Order ”.

Autor/Bashkëautor/Kontribues : Migena Leskoviku dhe Besnik Maho.

Subjekti/Institucioni botues/publikues : EPLO. Address; 64th Km Sounion Ave. 19500, Athina, Greece.

Koha e prezantimit: 10-12 Shtator, 2010.

Titulli i publikimit/ Kërkimit shkencor : “Transferimi i pasurive te paluajtshme, nje aset i rendesishem për mirëfunksionimin e organeve të qeverisjes vendore”.

Autor/Bashkëautor/Kontribues : Besnik Maho

Subjekti/Institucioni botues/publikues : Universiteti European i Tiranës, revista shkencore “Jus&Justicia”.

Koha e publikimit: Qershor, 2010.

Titulli i publikimit/ Kërkimit shkencor : Konferenca Shkencore me temë “Qeverisja vendore në Shqipëri, realitete dhe sfida dhe e ardhmja në kuadër të proceseve integruese” organizuar nga UET ku mbajta referatin me titull “Transferimi i pasurive te paluajtshme, nje aset i rendesishem për mirëfunksionimin e organeve të qeverisjes vendore”.

Subjekti/Institucioni botues/publikues : Universiteti European i Tiranës.

Koha e prezantimit: Prill, 2010.

Titulli i publikimit/ Kërkimit shkencor : Konferenca Shkencore me temë “Ligji, norma, tradita”. Në këtë konferencë kam mbajtur referimin me titull “Miratimi, publikimi, interpretimi dhe zbatimi i akteve normative në Republikën e Shqipërisë”.

Autor/Bashkëautor/Kontribues : Besnik Maho

Subjekti/Institucioni botues/publikues : Universiteti European i Tiranës.

Koha e prezantimit: 10 Nentor, 2009.

Titulli i publikimit/ Kërkimit shkencor : “Rregjistrimi i pasurive të paluajtshme, një kusht i domosdoshëm për formalizimin e titujve të pronësisë, si dhe për të rritur transparencën në atë fushë”.

Autor/Bashkëautor/Kontribues : Besnik Maho

Subjekti/Institucioni botues/publikues : Universiteti Europian i Tiranës, revista shkencore “Jus& Justicia”.

Koha e publikimit: Shtator, 2009.

Titulli i publikimit/ Kërkimit shkencor : Konferenca Shkencore me temë: “E drejta e pronës gjatë 20 viteve postkomunizëm në Republikën e Shqipërisë”. Në këtë konferencë kam mbajtur referimin me titull “Regjistrimi I titujve te pronësie dhe problematika që ekziston në këtë drejtim në Republikën e Shqipërisë”, duke pasur një rol kryesor në organizimin e saj.

Autor/Bashkëautor/Kontribues : Besnik Maho

Subjekti/Institucioni botues/publikues : Universiteti Europian i Tiranës.

Koha e prezantimit: 20 Qershor, 2009.

Titulli i publikimit/ Kërkimit shkencor : “Fitimi i pronësive mbi sende te paluajtshme”, monografi.

Autor/Bashkëautor/Kontribues : Besnik Maho

Subjekti/Institucioni botues/publikues : Shtëpia botuese UET Press.

Koha e publikimit: Prill, 2009.

Titulli i publikimit/ Kërkimit shkencor : Seminar me temë “Risiti e ligjit 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” në cilësinë e bashkëelektorit kam drejtuar këtë seminar organizuar në qytetin e Korçës me përfaqësues të Autoritetit të Konkurrencës dhe mbështetjen e GIZ.

Autor/Bashkëautor/Kontribues : Zef Preci dhe Besnik Maho në cilësinë e drejtuesve të seminarit.

Koha e prezantimit: Dhjetor, 2004.

Titulli i publikimit/ Kërkimit shkencor : “Konkurrenca shqiptare dhe sfidat europiane”.

Autor/Bashkëautor/Kontribues : Besnik Maho.

Subjekti/Institucioni botues/publikues : Revista shkencore “Jeta Parlamentare”.

Koha e publikimit: Shtator, 2004.

Titulli i publikimit/ Kërkimit shkencor : “Shtrat I përshtatshëm për konkurrencën”.

Autor/Bashkëautor/Kontribues : Besnik Maho

Subjekti/Institucioni botues/publikues : Revista shkencore “Tribuna Juridike”.

Koha e publikimit: Qershor, 2004.

32. Mbështetur në këto të dhëna të lidhura me përgjegjësitë dhe funksionet e natyrës teknike e profesionale që ka ushtruar kandidati, si dhe në tematikën e përmbajtjen e produkteve profesionale të botuara, detyrat konkrete të realizuara prej saj në ushtrimin e detyrës së Këshilltares Ligjore. Komiteti vlerëson se në aspektin sasior kandidati BESNIK MAHO ka tregues të lartë dhe të dallueshëm të angazhimi profesional, i cili tejkalon nivelin e angazhimit të zakonshëm apo “mesatar” në ushtrimin e profesionit. Për këto arsye, Komiteti çmoi ta vlerësojë kandidatin BESNIK MAHO për këtë kriter ligjor vlerësimi me **5 (pesë) Pikë**.

33. Për sa i përket vlerësimit cilësor, Komiteti shqyrtoi të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidati, veçanërisht pesë prej dokumenteve të përzgjedhura prej tij, me synimin për të evidentuar, bazuar në tregues shkencorë, elementë që dëshmojnë arritjen e rezultateve profesionale, shkallën e këtyre arritjeve, përfshirë elementë që nga këto dokumente profesionalë dhe në tërësi nga veprimtaria profesionale e kandidatit dëshmojnë përgatitjen e spikatur juridike në kuptimin dhe qëllimin për të cilin Kushtetuta dhe ligji e përcakton si kusht për vlerësimin e kandidaturës për këtë Komitet dhe, më tej, për përzgjedhjen e Inspektorit Jomagjistrat.’

34. Në veprimet përgatitore të kryera gjatë procedurave të verifikimit të kandidaturës, në datën 23.11.2020, kandidati BESNIK MAHO ka njoftuar Komitetin me shkrim se për qëllimet e procedurës së vlerësimit në kuadër të pikëzimit për “Kualifikimin e Përgjithshëm Profesional” dhe “Kualifikimin Shtesë Profesional”, ka përzgjedhur pesë dokumentet profesionale si më poshtë:

- Justice Reform in Albania, publishing in Ninth International Conference on: “Social and Natural Sciences – Global Challenge 2020”. Organized by International Institute for Private, Commercial and Competition Law, Stockholm, Suede, November 2020 with co-authors Aferdita Maho & Besnik Maho
- Real estate reform during the years 2015-2020 in Albania regarding AMTP registration and legalization of ownership, publishing in Tenth International Conference on: “Social and Natural Sciences – Global Challenge 2020”. Organized by International Institute for Private, Commercial and Competition Law, in Lisbon, Portugal, November, 2020 with co-authors Aferdita Maho & Besnik Maho
- Achievements and challenges about re-evaluation process of judges and prosecutors in the republic of Albania. Botuar Ne revisten shkencore austriake me faktor impakti (Academic Journal of Business, Administration, Law and Social Sciences) (AJBALS), Vienne, Austria, November 2020 with co-authors Aferdita Maho & Besnik Maho
- **Titulli i publikimit/ Kërkimit shkencor** : “Padia për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv. Kushtet që duhet të plotesohen për ngritjen dhe shqyrtimin e kësaj padie nga gjykata”. Autor/Bashkëautor/Kontribues : Besnik Maho.
- **Titulli i publikimit/ Kërkimit shkencor** : Ne Konferencen Shkencore Ndërkombëtare “Dinamizmi i reformave dhe ndikimi i tyre në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, politik dhe social”, kam prezantuar punimin “Reformimi i sistemit te drejtesise ne Shqiperi. Sfidat qe ai mbart”.Autor/Bashkëautor/Kontribues : Besnik Maho dhe Donald Zeqo.

35. Në lidhje me tërësinë e dokumenteve profesionale të paraqitura nga kandidati BESNIK MAHO dhe, në veçanti, lidhur me pesë dokumentet profesionale të sipërcituara, për realizimin e vlerësimit profesional dhe të pikëzimit përkatës për këtë kriter ligjor vlerësimi, Komiteti shqyrtoi dhe bisedoi në mënyrë të posaçme dhe të kujdesshme përmbajtjen e tyre, duke u mbështetur mbi indikatorë shkencorë si dhe në orientime që përmbahen në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për Inspektor (shtojca nr.2)

36. Dokumentet profesionale të shqyrtuara trajtojnë tematika të ndryshme të fushës së të drejtës, të cilat janë elaboruar mjaft mirë nga pikëpamja cilësore.

37. Njëri ndër indikatorët vlerësues të dokumenteve profesionale është “*Originaliteti dhe/ose impakti (duke përfshirë kontrollin për plagjiaturë) të dokumentit*”. Nisur nga profilet profesionale të kandidatit BESNIK MAHO përmbajtja e dokumenteve të analizuara, tematikës dhe dobisë së përdorimit të tyre nga profesionistë të fushës, grupe interesi, funksionarët publikë dhe publiku i gjerë. Komiteti vëren se pesë dokumentet profesionale të shqyrtuara, sikurse edhe në dokumentet e tjera të paraqitura, dëshmojnë qasje profesionale origjinale dhe të thelluara të çështjeve ligjore të përzgjedhura për trajtim, për të ka një interes të veçantë për njohje dhe zbatim. Për rrjedhojë, krahas origjinalitetit në përzgjedhjen e tematikave dhe trajtimin e tyre, kandidata ka sjellë argumente dhe përfundime me interes, të cilat ndikojnë pozitivisht në zhvillimin e debatit profesional e doktrinal në tërësi dhe në veçanti evidentojnë nevojën për ndryshime ligjore në të ardhmen në fushat përkatëse të trajtimeve të përzgjedhura. Për këto arsye, Komiteti çmoi ta vlerësojë kandidatin BESNIK MAHO për këtë kriter ligjor vlerësimi me **6 (gjashtw) Pikë**.

38. Për sa i përket treguesit vlerësues të lidhur me “*Aftësitë analitike*”, Komiteti vëren se veçanërisht në pesë dokumentet profesionale të shqyrtuara kandidati BESNIK MAHO tregon zotërimin e aftësive shumë të mira për të analizuar problematikat ligjore në tematikat e zgjedhura dhe për të zbatuar institutet e së drejtës sipas natyrës dhe qëllimit të këtyre punimeve duke arritur në konkluzione llogjike e ligjore. Për këto arsye, Komiteti çmoi ta vlerësojë kandidatin BESNIK MAHO për këtë kriter ligjor vlerësimi me **6 (gjashtë) Pikë**.

39. Për sa i përket treguesit vlerësues të lidhur me “*Aftësitë kërkimore*” Komiteti shqyrtoi veçanërisht pesë dokumentet profesionale të përzgjedhura nga kandidati BESNIK MAHO, sikurse edhe dokumentet e tjerë profesionale të paraqitur në dosjen e kandidatit. Nga ky shqyrtim Komiteti vëren se këto punime përmbajnë informacione të larmishme profesionale, të përdorura dhe të lidhura efektivisht me natyrën, qëllimin dhe përmbajtjen e secilit prej punimeve të shqyrtuara, të nxjerra nga burime të ndryshme të doktrinës dhe praktikës gjyqësore vendase si dhe doktrinës së shteteve të ndryshme dhe institucioneve të gjykatave ndërkombëtare.

40. Për rrjedhojë pas shqyrtimit dhe analizës mbi dokumentacionin profesional të paraqitur, në lidhje me treguesin “*Aftësitë kërkimore*”, Komiteti e vlerëson kandidatin BESNIK MAHO me **3.6 (tre pik gjashte) Pikë**.

41. Sipas treguesit *“Saktësia dhe precizioni”* në thelb verifikohet nëse në veprimtarinë e tyre profesionale kandidatët kanë mbuluar me profesionalizëm tematikën e përzgjedhur dhe materiali ka shmangur përsëritjet apo citimet e panevojshme etj. Nga shqyrtimi i dokumenteve profesionale të përzgjedhura nga kandidati BESNIK MAHO sikurse edhe i dokumenteve të tjerë profesionale të paraqitur në dosjen e kandidates. Komiteti vëren se këto punime tregojnë nivel të lartë të përcaktimit të tematikës dhe problemeve juridike për analizë dhe zgjidhje, përdorim të pasur dhe korrekt të terminologjisë juridike dhe strukturim e përdorim në mënyrën dhe vendin e duhur të gjetjeve nga legjislacioni, doktrina, si edhe praktika gjyqësore shqiptare dhe e huaj.

42. Për rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe analizës mbi dokumentacionin profesional të paraqitur, në lidhje me treguesin *“Saktësia dhe precizioni”*, Komiteti e vlerëson kandidatja BESNIK MAHO Sorraj **me 4 (kater) Pikë.**

43. Përsa i përket treguesit *“Qartësia”* Komiteti shqyrtoi pesë dokumentet profesionale të përzgjedhura nga kandidati BESNIK MAHO, sikurse edhe dokumentet e tjerë profesionale të paraqitur në dosjen e kandidatit dhe vëren se në këto punime janë të organizuara dhe strukturuara në mënyrën e duhur, gjuha e përdorur është e pasur por njëkohësisht edhe korrekte, e thjeshtë dhe e një niveli të lartë profesional. Pasuria, qartësia e gjuhës së përdorur dhe organizimi i duhur i materialit i bëjnë këto punime të kuptueshme dhe të lexueshme, sipas natyrës së punimit dhe grupeve të interesit të cilave synon të drejtohet.

44. Për rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe analizës mbi dokumentacionin profesional të paraqitur, në lidhje me treguesin *“Qartësia”*, Komiteti e vlerëson kandidatin BESNIK MAHO me 4 (katër) Pikë.

45. Pas shqyrtimit dhe analizës së pesë indikatorëve të mësipërm që përbëjnë vlerësimin cilësor të dokumentacionit profesional të paraqitur nga kandidati, Komiteti çmoi ta vlerësojë kandidatin BESNIK MAHO me **23.6 (njwzet e tre pik gjashtw) Pikë.**

Meritat profesionale- Kualifikimi Shtesë Profesional

46. Në Urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” në lidhje me kualifikimin shtesë profesional, përcaktohen si kritere vlerësimi që kandidatët të kenë

veprimtari të spikatur profesionale përgjatë ushtrimit të profesionit sipas profileve përkatëse në fusha të ndryshme të së drejtës, vlerësim të dallueshëm të rëndësisë së punimeve akademike, shkencore, shkrimeve, ligjëratave dhe dokumenteve të tjera profesionale, të ketë përvoja apo të dëshmojë aftësi të treguar e të provueshme posaçërisht edhe në fushën e inspektimeve dhe hetimeve, duke përfshirë veprimtari verifikuese, hetimore a gjyqësore në fushën penale, civile, administrative, disiplinore ose të drejtave të njeriut, sikurse edhe në administratën publike, ose në çështjet e analizave të menaxhimit. Gjithashtu, kandidatët vlerësohen edhe në lidhje me pjesëmarrje të dallueshme në procesin e hartimit ose të konsultimit të legjislationit dhe çdo angazhim tjetër profesional të kandidatit përgjatë 5 viteve të fundit në fushën e së drejtës.

47. Rezultatet profesionale në lidhje me këtë kriter vlerësimi shqyrtohen nga Komiteti për të vlerësuar veçanërisht rëndësinë dhe dobinë e profilizimit dhe specializimit të arritur në përvojat e veçanta profesionale të kandidatit të cilat tregojnë vlera të spikatura profesionale në shërbim funksionit të Inspektorit jo magjistratë, përfshirë këtu vlerësimin e njohurive të posaçme profesionale në lidhje me ushtrimin e kompetencave të kontrollit, inspektimeve, hetimeve disiplinore.

48. Prandaj, në zbatim të ligjit, në varësi edhe të profileve dhe karrierave profesionale të secilit kandidat, nga totali prej 10 pikësh për këtë kategori vlerësimi, Komiteti vlerëson deri në 7 pikë ekspertizën në fushat e së drejtës dhe posaçërisht në çështjet e ushtrimit të kompetencave me natyrë kontrolli, inspektimi, hetimi disiplinor si edhe kompetencave të tjera që përcaktohen nga ligji. Gjithashtu, Komiteti vlerëson deri në 3 pikë angazhimet profesionale shtesë të kandidatëve. Në arsyetimin dhe përfundimet e tij Komiteti mban parasysh rregullat e hollësishme të përcaktuara në Urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

49. Në rastin e kandidatit BESNIK MAHO, krahas jetëshkrimit, intervistës dhe motivimit për kandidim. Komiteti shqyrtoi dokumentet profesionale dhe të dhënat që mund të disponoheshin nga veprimtaritë e ndryshme profesionale, si edhe nga kontributet e tjera profesionale të kësaj kandidate në veprimtari të ndryshme, përfshirë publikime apo punime shkencore, pjesëmarrje në veprimtari të tjera profesionale të lidhura me fushat e së drejtës.

Përvoja dhe cilësi profesionale të posaçme për rolin e Inspektorit jo magjistratë

50. Përsa i përket kriterit të parë vlerësues, relevanca e eksperiencës profesionale në lidhje me rolin dhe funksionet e Inspektorit Jomagjistrat nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista dhe dokumentet e tjera zyrtare mbi rezultatet e vlerësimit profesional etj si edhe nga shqyrtimi i dokumenteve profesionale të paraqitura nga kandidati BESNIK MAHO. Komitetit i rezulton se historiku dhe karriera profesionale e këtij kandidati është i fokusuar në pjesën më të madhe të kohëzgjatjes dhe shtrirjes së saj në fushën e drejtësisë kushtetuese, të drejtës publike pa lënë mënjanë cdo fushë të së drejtës për vetë profilin e lartë të karrierës që ka mbajtur kandidati.

51. Nga ana tjetër Komiteti vëren edhe se në formimin profesional, specializimin dhe ekspertizën e posaçme profesionale të fituar nga kandidati BESNIK MAHO, një rol të veçantë ka edhe interesi i treguar për ushtrimin e vazhdueshëm të veprimtarive të tjera profesionale në fusha të ndryshme të së drejtës me kohë të pjesshme si pedagog i brendshëm dhe i jashtëm në fushën e të drejtës publike, administrative, edhe të drejtës kushtetuese. Nga ana tjetër studimet pasuniversitare të ndjekura nga kandidati si në programin master dhe në atë të doktoraturës si dhe një sërë trajnimesh të zhvilluara në Shtetete e Bashkuara të Amerikës, tregojnë për një përgatitje të lartë profesionale të kandidatit. Komiteti ka vendosur ta vlerësoj kandidatin për **kete aspekt me shtate pike**.

52. Nisur nga kjo veprimtari profesionale, Komiteti vlerëson se kandidati BESNIK MAHO dëshmon jo vetëm formimin e saj të plotë juridiko-profesional, por edhe se ka arritur një nivel të spikatur jo vetëm teorik por edhe të zbatimit e të ndikimit efektiv në praktikë të specializimit dhe ekspertizës ligjore, të thelluar sidomos në fushën e të drejtës kushtetuese.

53. Në të drejtën publike si dhe në çështjet e mirëadministrimit të veprimtarisë së institucioneve të drejtësisë përfshirë edhe ato me përgjegjësi dhe kompetenca të natyrës kontrolluese dhe inspektuese ndaj gjyqtarëve e prokurorëve si subjekte të rivlerësimit.

Angazhime profesionale shtesë

54. Përsa i përket kriterit të dytë vlerësues, angazhimeve profesionale shtesë sipas të dhënave që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista dhe dokumentet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidates BESNIK MAHO, rezulton që përgjatë gjithë karrierës së saj profesionale, ky kandidat ka qenë lektor (si më sipër). Këto angazhime shtesë janë kryer në të

shumtën e kohës në cilësinë e pedagogut të brendshëm dhe të jashtëm dhe vazhdojnë pothuajse gjatë gjithë karrierës së tij profesionale.

55. Prandaj, duke pasur parasysh këto angazhime të shtesë profesionale, të shtrira në kohë dhe me kontribute konkrete profesionale në disa nga fushat më të rëndësishme të së drejtës, Komiteti vlerëson që për kriterin vlerësues të angazhimeve profesionale të shtesë ti caktojë kandidatit **BESNIK MAHO me 3 (tre) Pikë.**

Meritat Morale

56. Në zbatim të shkronjës “b” të pikës 6, të nenit 240 të ligjit nr.115/2016 si kriter vlerësimi është përcaktuar që kandidatët të jenë vlerësuar për integritet të lartë moral dhe përgatitje të lartë profesionale. Në bazë dhe për zbatimin të ligjit lidhur me këto vlerësime ka dalë Urdhri Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” ku përcaktohen rregullime më të hollësishme si edhe shpërndarja e pikëve të vlerësimit sipas peshës specifike të këtyre kriterëve.

57. Prandaj, në zbatim të ligjit, lidhur me meritat morale, nga totali prej 25 pikësh për të tre komponentët vlerësues Komiteti vlerëson deri në 15 pikë integritetin etik dhe moral, deri në 8 pikë reputacionin që gezon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve dhe deri në 2 pikë angazhimin e provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile. Në arsyetimin dhe përfundimet e tij Komiteti mban parasysh rregullat e hollësishme të përcaktuara me Urdhrin Nr. 7, datë 04.03.2020.

58. Në rastin e kandidatit BESNIK MAHO krahas jetëshkrimit, paraqitjes dhe sjelljes gjatë parashtrimeve në intervistë, motivimit për kandidim dhe historikut të komunikimit të kandidatit me Komitetin gjatë procesit të verifikimit dhe vlerësimit të kandidatures. Komiteti shqyrtoi të dhenat nga dokumentet profesionale, aktet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidatit si edhe çdo të dhënë a dokument tjetër të aksesueshëm publikisht nëpërmjet të cilave mund të nxirreshin elementë të dobishëm për qëllimet e verifikimit dhe vlerësimit të meritave morale të këtij kandidati.

Integriteti etik e moral

59. Për sa i perket kriterit të parë vlerësues, *integritetit etik e moral*. nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista, komunikimi i kandidatit me Komitetin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe nëa dokumente të tjera zyrtare apo të aksesueshme publikisht. Komitetit i rezulton se kandidatja BESNIK MAHO në veprimtarinë, sjelljen dhe komunikimin e saj tregon përkushtim dhe angazhim të ndergjegjshëm në përmbushjen e detyrave profesionale dhe në ushtrimin e profesionit si edhe vëmendje, ndjeshmëri dhe respekt në komunikim e bisedë, duke parashtruar argumentet e tij me kompetencë, dinjitet, duke degjuar dhe pergjigjur me kujdesin e duhur, me durim e vetëpërmbytje përkundrejt qëndrimeve dhe pyetjeve të cilat i drejtohen nga bashkëbiseduesit

60. Nga të dhënat e mundshme në dispozicion, Komitetit nuk i rezulton që kandidatja BESNIK MAHO të ushtrojë apo të ketë ushtruar funksionet e saj profesionale duke favorizuar palë të caktuara apo duke kërkuar përfitime për veten apo për të tjerët. Nuk rezultojnë të dhëna që ky kandidatë të mos ketë respektuar detyrimin profesional të nderit dhe te dinjitetit, ndërimit të marrëdhënieve profesionale dhe mirësjelljes në raport me koleget, profesionistët e fushës, palët e përfshira në çështje pune etj.. Pra nuk ka të dhëna që me sjelljen dhe veprimtarinë e saj në jetën profesionale dhe personale të ketë cënuar apo të rrezikojë të cenojë imazhin dhe figurën publike të nëpunësit shtetëror dhe sistemit të drejtësisë.

61. Prandaj në lidhje me kriterin vlerësues të *integritetit etik e moral* Komiteti e vlerëson kandidatin BESNIK MAHO **me 15 (pesëmbëdhjetë) Pikë.**

Reputacioni që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve

62. Për sa i perket kriterit të dytë vlerësues "*reputacioni që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve*", nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim. Intervista, komunikimi i kandidatit me Komitetin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit si edhe nga dokumentet e tjera zyrtare apo të aksesueshme publikisht. Komitetit i rezulton se kandidati Besnik MAHO në veprimtarinë, sjelljen dhe komunikimin e tij tregon angazhim dhe përkushtim në përmbushjen e detyrave për zbatimin e drejtë të ligjit në ushtrimin e kompetencave dhe të pergjegjësive, që i ngarkon ligji.

63. Sipas të dhënave që disponohen Komiteti vëren së kandidati BESNIK MAHO ka përmbushur me korrektesë detyrimet profesionale, duke i ushtruar me seriozitet, maturi dhe besnikëri funksionet e ndryshme gjatë karrierës profesionale . Gjithashtu, kandidati reflekton angazhim seriozitet dhe përgjegjshmëri të lartë gjatë prezantimit të tij në intervistën e realizuar para Komitetit të Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve. Nga ana tjetër Komiteti vëren se nuk ka të dhëna që të tregojnë se ky kandidat në kryerjen e detyres dhe në jetën personale të ketë kryer veprimtari që rezultojnë përtej kufijve ligjorë në raport me statusin dhe detyrat profesionale të kryera.

64. Prandaj, duke konstatuar se me sjelljen dhe veprimtarinë e tij përmbush të gjitha pritshmëritë e aspektit moral për marrjen e përgjegjësisë ligjore dhe institucionale, si edhe pritshmërinë e publikut për gezimin e cilësive profesionale e morale për ushtrimin e detyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në lidhje me kriterin vlerësues të *“reputacioni që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve”* Komiteti e vlerëson kandidatin BESNIK MAHO **me 8 (tetë) Pikë.**

Angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile

65. Për sa i përket kriterit të tretë vlerësues *“angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile”* nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista, komunikimi i kandidates me Komitetin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe nga dokumente të tjera zyrtare apo të aksesueshme publikisht, Komitetit i rezulton se, përgjithësisht, kandidati BESNIK MAHO nuk ka qenë e angazhuar nga veprimtari të tjera të përshtatshme jashtë atyre të lidhura me ushtrimin e detyrës ose të profesionit për ndjekje të kauzave të shoqërisë civile.

66. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të *“merita morale-angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile”* Komiteti e vlerëson kandidatin BESNIK MAHO **me 0 (zero) Pikë.**

Meritat organizative, drejtuese dhe menaxheriale

67. Në Urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” parashikohen si kritere vlerësimi disa komponentë të lidhur me aftësitë profesionale dhe

personale të kandidatëve mbi aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore. Kështu, parashikohen kriteret vlerësuese për kandidatët si më poshtë:

- a) cilësinë e platformës dhe të vizionit që paraqesin
- b) aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore;
- c) aftësitë e komunikimit;
- ç) aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore;
- d) aftësitë e përfaqësimit publik.

68. Lidhur me meritat organizative, drejtuese dhe menaxheriale nga totali prej 25 pikësh për të pesë komponentët vlerësues të sipërcituar, Komiteti vlerëson deri në 8 pikë cilësinë e platformës dhe të vizionit që paraqesin kandidatët, deri në 10 pikë aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore deri në 5 pikë aftësitë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publikë si edhe me 2 pikë për aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore. Në arsyetimin dhe përfundimet e tij Komiteti mban parasysh rregullat e hollësishme të përcaktuara me Urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

69. Në rastin e kandidates BESNIK MAHO krahas jetëshkrimit, paraqitjes dhe sjelljes gjatë parashtrimeve dhe bisedës në intervistë, përmbajtjes së motivimit për kandidim dhe historikut të komunikimit të kandidates me Komitetin gjatë procesit të verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturës Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve shqyrtoi të dhënat nga dokumentet profesionale, aktet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidates, si edhe çdo të dhënë a dokument tjetër të aksesueshëm publikisht nëpërmjet të cilave mund të nxirreshin elementë të dobishëm për qëllimet e verifikimit dhe vlerësimit të meritave organizative, drejtuese dhe menaxheriale të kandidatit.

Cilësia e platformës dhe e vizionit

70. Komiteti shqyrtoi përmbajtjen e dokumentit me shkrim, platformës mbi motivimit dhe vizionit të kandidatit BESNIK MAHO lidhur me qasjen dhe qëndrimet e tij mbi rëndësinë dhe aspektet thelbësore të ushtrimit të detyrës së Inspektorit Jomagijsrat, mbi sfidat kryesore me të cilat duhet

të përballet në ushtrimin e përgjegjësive dhe kompetencave që i ngarkon ligji. Në vlerësimin e këtij kriteri, Komiteti mban parasysh edhe parashtrimet dhe shpjegimet e dhëna nga kandidati gjatë intervistës dhe në përgjigje të pyetjeve që drejtuan anëtarët e Komitetit.

71. Nisur nga dokumenti me shkrim dhe shpjegimet e paraqitura gjatë intervistës, Komiteti vëren se kandidati BESNIK MAHO paraqiti një nivel shumë të mirë të njohjes dhe përvojës profesionale së tij në lidhje me rolin dhe pritshmëritë për ushtrimin e funksionit të Inspektorit Jomagjistrat. Kandidati gjithashtu parashtrori me maturi, në mënyrë profesionale të hollësishme çështje dhe problematika të larmishme ligjore me të cilat duhet të përballet Inspektori Jomagjistrat.

72. Prandaj në lidhje me kriterin vlerësues “*cilësia e platformës dhe të vizionit të paraqitur*” nga kandidati, Komiteti e vlereson kandidatin BESNIK MAHO me 7 (shtatw) Pikë.

Aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore

73. Lidhur me “*aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi*” Komiteti mbështetet pikësepari në të dhënat që lidhen me përvoja konkrete nga karriera e kandidatëve në funksione dhe pozicione të cilat kërkojnë dhe tregojnë marrjen përsiper të përgjegjësive dhe ushtrimin e vendimmarrjes në përmbushjen e kompetencave dhe të detyrave të ngarkuara. Komiteti shqyrton dhe vlerëson posaçërisht aftësitë e provuara ose premtuese për të marrë nisma, për të kërkuar zgjidhje, për të marrë përgjegjësi si edhe për të marrë vendimet e duhura e në kohën e duhur sipas përcaktimeve të ligjit dhe në përgjigje të ndjeshmërisë së publikut.

74. Në rastin e kandidates BESNIK MAHO, krahasjetëshkrimit, parashkrimeve dhe bisedës në intervistë, përmbajtjes së platformës dhe motivimit për kandidim, Komiteti shqyrtoi të dhënat nga dokumentet profesionale, si edhe aktet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidates, për të evidentuar të dhëna në lidhje me aftësitë e provuara apo premtuese të këtij kandidati për të marrë vendime dhe përgjegjësi edhe në ushtrimin e funksionit të Inspektorit jomagjistrat.

75. Komiteti vëren se kandidati BESNIK MAHO ka qenw gjyqtar dhe pedagog duke dhënë ndihmë të drejtëpërdrejtë në realizimin e nje procesi shumë të rëndësishëm kushtetues .

76. Statusi i veçantë i mbajtur nga kandidati konkretisht në rolin e specialistit profesionist për shqyrtimin dhe evidentimin e problematikave në sistemin e drejtësisë dhe asistencë e

vazhdueshme që ajo i ka dhënë organeve vendimmarrëse në këtë drejtim dëshmojnë të dhëna premtuese për marrjen e përgjegjësive dhe nismës për vendimmarrje në përmbushjen e detyrave që i ka ngarkuar ligji përfshirë edhe ato të lidhura me aspektet e administrimit dhe të drejtimit të institucioneve dhe njësive përkatëse të administratës shtetërore.

77. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues *aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore*”, Komiteti e vlerëson kandidatin BESNIK MAHO me 6 (gjashte) Pikë.

Aftësitë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik

78. Aftësitë e komunikimit, në të gjitha format, veçanërisht me nëpunësit dhe punonjësit e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me gjyqtarët dhe prokurorët, të shprehurit në mënyre të qartë lehtësisht të kuptueshme, të matur, me respekt dhe në mënyrë jodiskriminuese, luajnë një rol të rëndësishëm në kryerjen e funksionit të Inspektorit Jomagjistat.

79. Nga shqyrtimi i jetëshkrimit, sjellja, mënyra e komunikimit dhe argumentimit gjatë bisedës në intervistë si edhe nga përmbajtja, strukturimi dhe stili i hartimit të dokumenteve profesionale të administruara në dosjen e kandidatës. Komiteti vëren se kandidati BESNIK MAHO zotëron aftësi shumë të mira për të komunikuar me maturi, për të degjuar me respekt dhe për tu përgjigjur me profesionalizëm, qartësi e thjeshtësi, me stil dhe gjuhë të pasur në lidhje me të gjitha çështjet dhe problematikat që vlerëson të trajtohen. ashtu edhe për çështje dhe problematika që ngrihen nga të tjerët.

80. Gjithashtu, referuar prezantimit të bërë gjatë intervistës, rezulton se kjo candidate prezanton thjeshtësi, aftësi për të shprehur bindjet e saj me vetëbesim. Kandidati transmeton besueshmëri gjatë komunikimit dhe aftësi të dallueshme për tu përgjigjur me etikë pa krijuar konfuzion tek të tjerët, qofshin këta profesionistë të së drejtës ose jo.

81. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të “Aftësitë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik” Komiteti e vlerëson kandidatin BESNIK MAHO **me 5 (pesë) Pikë.**

Aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidiplinare ose multikulturale

82. Inspektori jomagjistrat, duhet të zotërojë aftësitë e duhura për një qasje metodike ndaj punës si dhe aftësinë për të organizuar dhe për të qenë i përfshirë në punën në grup. Pjesë e kësaj atësie është edhe nevoja për t'u përshtatur shpejt me zhvillimet e reja, si edhe ndaj nevojës për tu përfshirë në veprimtari në ambiente multikulturore dhe multidisiplinore gjatë karrierës gjyqësore.

83. Nga shqyrtimi i jetëshkrimit, sjellja, mënyra e komunikimit dhe argumentimit gjatë bisedës në intervistë si edhe nga dokumentet profesionale të administruara në dojen e kandidatit, Komiteti vëren se kandidati BESNIK MAHO zotëron aftësitë e duhura për të punuar në grup, përfshirë atë për të punuar në ambiente multikulturore dhe multidisiplinore.

84. Gjithashtu, ushtrimi për një kohë të gjatë të detyrës së specialistit pranë këshilltarit juridik të Presidentit, specialistes së marrëdhënieve me gjyqësorin, këshilltares ligjore në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit për vetë mënyrën kolegjiale dhe punën në grup që kërkohet në këtë pozicion për përgatitjen e çështjeve për shqyrtim, bisedimin e zgjidhjes së tyre i kanë mundur kandidatit fitimin e pervojës dhe shprehive të duhura për punën në grup dhe në çështje e situata të larmishme. Zotërimi i këtyre aftësive rezulton i reflektuar edhe në komunikimin e bisedën e zhvilluar me Komitetin gjatë intervistës.

85. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues "Aftësitë e të punuarit dhe në ambiente multidiplinare ose multikulturore, Komiteti vlerëson ti caktojë kandidatit BESNIK MAHO 2 (dy) Pikë.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të Vendimit nr. 536, datë 25.07.2019 të Komitetit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", Urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", Inspektori i Lartë i Drejtësisë:

VENDOSI:

1. Vlerësimin e kandidatit BESNIK MAHO, me **90.6 (nëntëdhjetë pik gjashtë)** pikë, në lidhje me kandidimin e saj për vendin vakant **Inspektor Jomagjistrat**, të shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 07.02.2020.

2. Ky vendim i njoftohet kandidatit BESNIK MAHO.

3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në pjesën e përcaktuar për “Rekrutim Inspektor Jo magjistrat”.

ANËTARE
Mirela KAPO



ANËTARE
Marsela PEPI



KRYETARI
Artur Metani

